



Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”

Programe Specializimi Afatgjatë në Fushën e Mjekësisë

Shpallje Konkursi

Edicioni i IV, Viti Akademik 2021-2022

Tiranë

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” (referuar në vijim UniKZKM), themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 567, më datë 27.08.2004, në bashkëpunim didaktik me Universitetin e Romës “Tor Vergata”, hap për vitin akademik 2021-2022, në vijim të aprovimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Republikën e Shqipërisë në vijim të Urdhrit Nr. 664, të datës 28.12.2017 “Për aktivizimin e programeve të studimit të ciklit të tretë, Specializime afatgjata pranë Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” dhe të Urdhrit Nr. 678, të datës 29.12.2017 “Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë, Specializime afatgjata pranë Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, Programe Specializimi afatgjatë në fushën e Mjekësisë, të Ciklit të III-të, për të diplomuarit në Mjekësi dhe Kirurgji të cilët kanë për qëllim zhvillimin e kompetencave specifike për ushtrimin e aktiviteteve mjekësore të specializuara në funksion të formimit profesional.

Neni 1 – Objektivat formues

Të diplomuarit në programet e specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë duhet të kenë:

- përgatitje të mirë profesionale dhe aftësi metodologjike, kulturore dhe profesionale të përparuara, të përshtatshme për të analizuar, interpretuar, vlerësuar dhe menaxhuar problematikat mjekësore të specializuara kirurgjikale;
- njohuri ndërdisiplinore për të planifikuar dhe zbatuar strategji të vepruari për menaxhimin e problematikave të natyrës shëndetësore me kompleksitet të lartë, aftësi për t’u integruar në tregun e punës të sistemit shëndetësor kombëtar dhe ndërkombëtar;
- aftësi për të përdorur rrjedhshëm, në formë të shkruar dhe me gojë, gjuhën italiane dhe të kenë njohuri të një prej gjuhëve të mëposhtme: gjuhë frënge, angleze, spanjolle, gjermane apo italiane, mbrojtur me certifikatë ndërkombëtare niveli C1 në zbatim të parashikimeve të Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë” dhe në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2 – Mundësitë e punësimit

Të diplomuarit në programet e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, të Ciklit të III-të, kanë mundësi punësimi të ndryshme dhe ushtrimin e aktiviteteve profesionale të specializuara në qendra shëndetësore publike dhe private të orientuara nga diagnostifikimi, përkujdesja, programimi dhe kërkimi shkencor në fushën e shëndetësisë (poliklinika, spitale, poliambulatorë, kompani farmaceutike, institute të sigurimit shëndetësor etj.) në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Neni 3 –Mësimdhënia, Praktikat dhe Stazhet

Për qëllimet e mësipërme, kurrikula e programeve të Specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, lidhur me objektivat specifike të trajnimit, parashikon aktivitete mësimore dhe praktika Mjeko-Kirurgjikale. Këto aktivitete do të rakordohen në bashkëpunim dhe partneritet me spitalet publike dhe private sipas marrëveshjeve të posaçme, në përputhje me Marrëveshjen e nënshkruar më 02.06.2016 midis UniKZKM dhe Ministrisë së Shëndetësisë Shqiptare. Si rregull, trajnimi i specializantëve nuk parashikon ndonjë angazhim në kohë pune në klinikat pritëse.

Universiteti nuk do të nënshkruajë asnjë kontratë lidhur me shpërblime të mundshme për specializantin.

Neni 4 -Kushtet për pranim

Lejohen të marrin pjesë në provën përzgjedhëse shtetasit shqiptarë, shtetasit e vendeve të Bashkimit Evropian si dhe të vendeve JO anëtare të Bashkimit Evropian që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Diplomë Master i Shkencave në Mjekësi dhe Kirurgji, ligjërisht e akredituar në momentin e lëshimit dhe e njohur nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Diplomë Master i Shkencave në Mjekësi dhe Kirurgji ose Farmaci për studentët që dëshirojnë të marrin pjesë në provën përzgjedhëse të Specializimit në Shkencat e të Ushqyerit;
- Liçencë për të ushtruar profesionin e Mjekut Kirurg (Certifikatë të Provimit të Shtetit dhe Vërtetim i Regjistrimit në Urdhrin e Mjekut);
- Kandidatët që nuk janë pajisur me licencën e ushtrimit të profesionit të Mjekut Kirurg mund aplikojnë dhe, në rast se rezultojnë fitues, pranohen me rezervë. Ata duhet të marrin licencën e ushtrimit të profesionit brenda vitit të parë të Specializimit në rast të kundërt përjashtohen nga Specializimi.
- Ata që janë të pajisur me Certifikatë ndërkombëtare në nivel C1, siç parashikohet në Udhëzimin e Ministrisë N. 52 datë 3/12/2015 për një nga gjuhët e huaja të mëposhtme: frëngjisht, anglisht, spanjisht, gjermanisht dhe italisht. Kjo certifikatë nuk i kërkohet shtetasve të Bashkimit Evropian që vijnë nga vendet ku përdoren gjuhët e cituara më sipër ose kanë përfunduar një cikël studimesh në gjuhët e lartpërmendura.

Neni 5- Mënyra e Pjesëmarrjes

Çdo kandidat mund të konkurojë maksimumi në dy Specializime të ndryshme duke përcaktuar qartësisht në kërkesën e pjesëmarrjes rendin e preferencës.

Për të aplikuar në Programet e Specializimeve Afatgjata në Fushën e Mjekësisë të Ciklit të III, kandidatët duhet të kryejnë regjistrimin online në portalin e Universitetit Katolik ZKM: <http://admissions.unizkm.al/> brenda datës **31 janar 2022 ora 23:59** duke bashkëlidhur dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular pararegjistrimi/Shtojca A (i shkarkueshëm në portalin <http://admissions.unizkm.al/> ose në faqen www.unizkm.al/;
- diplomë dhe listë notash të provimeve;
- diplomë universitare në origjinal;
- vërtetim i licencës për ushtrimin e profesionit të Mjekut Kirurg (Certifikata e Provimit të Shtetit ose Vërtetimi i Regjistrimit në Urdhrin e Mjekut);
- Curriculum Vitae et Studiorum në gjuhën italiane;
- fotokopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti);
- tituj të tjerë të mundshëm dhe vërtetime (punime shkencore publikuar në revista të specializuara, çertifikata për pjesëmarrje në projekte kërkimi, kurse perfeksionimi dhe specializimi, kurse gjuhe, Master, Doktorata etj.);
- vërtetim i pagesës së tarifës 100,00 Euro¹ si kontribut pjesëmarrjeje në seleksionim. Pagesa e tarifës kryhet në të njëjtin portal: <http://admissions.unizkm.al/> ose pranë Zyrës së Pranimeve të Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” në Rr. “Dritan Hoxha”, Tiranë, Shqipëri **brenda datës 28 janar 2022.**

Pagesa mund të kryhet edhe në filialet e Bankës Intesa SanPaolo në llogarinë me këto të dhëna:
Përfituesi: Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë (Universiteti Katolik)

- 1. IBAN AL60208112040000030694935302 për pagesat në Euro;
- 2. IBAN AL06208112040000030694935304 për pagesat në Lekë.

Në Urdhër pagesë duhet specifikuar emri dhe mbiemri si dhe Shkolla e Specializimit për të cilën kryhet pagesa. Pas mbërritjes së pagesës vijohet me kontrollin e dokumentave për secilin kandidat. Statusi i regjistrimit mund të verifikohet përmes aksesit në profilin personal në portalin e Universitetit.

Neni 6 -Mënyra e seleksionimit

Kandidatët që dëshirojnë të marrin pjesë në provën përzgjedhëse duhet të paraqiten me një dokument identifikimi të vlefshëm në auditoret e Universitetit Katolik ZKM në RR. Dritan Hoxha në Tiranë, Shqipëri.

Provat përzgjedhëse do të zhvillohen në datën 16/02/2022 ora 15:00.

Përzgjedhja e kandidatëve do të kryhet nga një Komision i posaçëm i emëruar me urdhër të Rektorit i cili do të vlerësojë titujt e paraqitur dhe rezultatet e provave të konkursit. Këto të fundit do të përqendrohen në tema të përgjithshme të Mjekësisë dhe tema që i referohen fushës së Specializimit për të cilën është duke konkurruar.

Prova e konkursit konsiston në një provë me shkrim dhe më pas një provë me gojë.

¹ Eventuali commissioni sono a carico dell'ordinante. Le tariffe devono arrivare complete nel conto bancario dell'Università, altrimenti l'iscrizione non è valida

Prova me shkrim do të fokusohet në një temë që do të kryhet mbi lëndët e mjekësisë së përgjithshme. Prova me gojë konsiston në një intervistë të kandidatit me Komisionin përkatës, gjatë të cilës do të diskutohen argumente nga kultura e përgjithshme mjekësore, duke iu referuar gjithashtu edhe atyre të trajtuara në provën me shkrim, si dhe temat që lidhen me fushën e specialitetit për të cilën konkurron.

Provat konsistojnë në një provë me shkrim dhe një provë me gojë.

Prova me shkrim zhvillohet mbi argumenta të Mjekësisë së përgjithshme.

Prova me gojë konsiston në një intervistë të kandidatit me Komisionin gjatë së cilës do të diskutohen argumente të kulturës së përgjithshme mjekësore, si dhe mbi temat e lidhur me provën me shkrim, gjithashtu argumenta që i përkasin fushës së specializimit për të cilën konkurojnë.

Për provën me shkrim Komisionet përkatëse të konkursit do të paracaktojnë tri tema midis të cilave do të përzgjidhet ajo që do të trajtohet gjatë provës. Gjatë provës me shkrim nuk lejohet konsultimi i asnjë teksti në rast të kundërt parashikohet përjashtimi nga konkursi.

Vlerësimi i kandidatëve dhe përzgjedhja e tyre do të bëhet nga Komisioni nëpërmjet konkursit të pranimit, i cili parashikon një sistem vlerësimi me në total 100 pikë të klasifikuara si më poshtë vijon:

1. 30 pikë- test mbi njohuritë e përgjithshme të fushës;
2. 40 pikë- test mbi njohuritë e posaçme të programit të specializimit;
3. 20 pikë- për notën mesatare të ponderuar e kandidatëve që janë diplomuar në Shqipëri dhe nota e diplomimit për kandidatët e diplomuar jashtë shtetit;
4. 10 pikë -për provën me gojë;

Mënyra e seleksionimit e përcaktuar më sipër mund të pësojë ndryshime në funksion të zhvillimit të situatës së emergjencës sanitare.

Në këtë rast ndryshimet do i komunikohen pjesëmarrësve në konkurs menjëherë.

Për të marrë pjesë në Konkursin e Specializimit, kandidatët e diplomuar në Shqipëri duhet të kenë një mesatare të ponderuar të notave të të gjitha viteve të Programit të Studimit në Mjekësi, jo më të ulët se 5 (pesë).

Në rast ex-aequo kanë përparësi ata që kanë marrë pikë më të larta në provën e pranimit.

Në programin e Specializimit do të pranohen kandidatët të cilët do të renditen fitues në listën e hartuar në bazë të rezultatit të përgjithshëm të pikëve të grumbulluara, në përputhje me numrin e kuotave në dispozicion.

Në rast se për një program specializimi nuk ka aplikime të mjaftueshme, Komisioni ka të drejtë të caktojë kuotat e lira për specializimet e tjera më të kërkuara.

Renditja zyrtare do të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit Katolik ZKM: <https://www.unizkm.al/> dhe pranë Sekretarisë Mësimore të Programit të Mjekësisë të Fakultetit të Mjekësisë pranë Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" brenda datës **21/02/2022**.

Neni 7 – Mënyra e regjistrimit në Programin e Specializimeve

Kandidatët fitues duhet të depozitojnë pranë Sekretarisë mësimore të Mjekësisë brenda datës **28/02/2022** kërkesën e regjistrimit rregullisht të nënshkruar dhe të plotësuar (sipas formularit të disponueshëm në Sekretari ose të shkarkueshëm në portalin e studentit <https://portal.unizkm.al/#/>);

- certifikatë diplomimi dhe listë notash të provimeve;

- diplomën origjinale;
- fotografi personale;
- vërtetimin e pagesës së tarifës vjetore si kontribut studimi prej 3000€ në vit për shtetasit shqiptarë që kryhet në një pagesë të vetme ose me dy këste prej 1500€, i pari në momentin e regjistrimit dhe i dyti brenda 30.09.2022; dhe 4500€ në vit për shtetasit e vendeve anëtare të BE dhe jo BE e cila duhet kryer në një pagesë të vetme në momentin e regjistrimit.
Për vitet në vijim tarifën si më sipër paguhen përkatësisht në datën 28 shkurt të çdo viti për tarifën vjetore të plotë për shtetasit anëtare të BE dhe jo BE ose për këstin e parë për shtetasit shqiptarë dhe 30 shtator të çdo viti për këstin e dytë për shtetasit shqiptarë.
- Vonesat në pagesat e kësteve ose tarifës vjetore të plotë shoqërohen me pagesën e një kamatvonesë sipas kushteve të mëposhtme:
 - Vonesë për tridhjetë ditët e para:
 - 100€ për këstin e parë apo tarifën vjetore;
 - 30€ për këstet e tjera
 - Vonesat mbi tridhjetë ditë: 15€ për çdo muaj

Aplikimet me mangësi në dokumentacion nuk do të merren parasysh dhe sekretaria do të procedojë duke thirrur kandidatin pasardhës në renditjen sipas meritës.

Sekretaria nuk është përgjegjëse për vonesa në dorëzimin e dokumentacionit të paplotë.

Universiteti regjistron kandidatin me rezervë, deri në momentin e matrikullimit nga Qendra e Shërbimeve Arsimore e Republikës së Shqipërisë (QSHA). Në rast të refuzimit të matrikullës për çdo arsye që lidhet me mos plotësimin e kriterëve nga ana e kandidatit Universiteti përjashtohet nga çdo përgjegjësi.

Fituesit të cilët nuk kryejnë regjistrimin brenda afatit të caktuar do të konsiderohen se kanë hequr dorë nga specializimi dhe do të zëvendësohen nga kandidatët pasardhës në renditje: për këta të fundit afati i regjistrimit është caktuar brenda datës së fillimit të leksioneve.

Shënim: Kandidatët që kanë përfunduar studimet e larta jashtë vendit duhet gjithashtu të kryejnë procedurën e njehsimit të diplomës universitare pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore të Republikës së Shqipërisë (QSHA) dhe të dorëzojnë pranë Sekretarisë Mësimore kopjen e dokumentit të njehsimit të diplomës të lëshuar nga QSHA.

Neni 8- Mënyra e zhvillimi të aktivitetit mësimor

Aktiviteti akademik teorik/klinik-praktik do të zhvillohet në strukturat shëndetësore të përshtatshme për këto qëllime, të vendosura paraprakisht me marrëveshje bashkëpunimi specifike të parashikuara në Marrëveshjen Kuadër nënshkruar mes UniKZKM dhe Ministrisë së Shëndetësisë Shqiptare dhe strukturave shëndetësore të cilat do të përcaktohen nga Përgjegjësit e secilit Program specializimi sipas nevojave të posaçme të vetë specializimit.


Praktikat klinike do të kryhen në strukturat shëndetësore të palëve partnere me të cilat ka marrëveshje. UniKZKM, në fillim të programit, do t'i komunikojë në kohë çdo kandidati fitues emrin e tutorit klinik/praktik dhe të strukturës shëndetësore ku do të kryhen aktivitetet klinike-praktike.

Neni 9– Lista e programeve të specializimit të hapura dhe numri i kuotave përkatëse për secilin program

Nr.	Program Specializimi në:	Kuota	Kohëzgjatja
1	Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive	4	5 vjet
2	Kirurgji e Përgjithshme	4	5 vjet
3	Gastroenterologji	2	4 vjet
4	Gjinekologji dhe Obstetrikë	4	5 vjet
5	Sëmundje të Aparatit Kardiovaskular	4	4 vjet
6	Nefrologji	2	5 vjet
7	Ortopedi dhe Traumatologji	3	5 vjet
8	Shkencat e të Ushqyerit	2	4 vjet

Rektori

Prof. Bruno Giardina



Tiranë, më 21/12/2021